

Imigrimi në Gjermani për qëllime pune: Rregullorja e Ballkanit Perëndimor dhe Ligji i imigracionit për punëtorë të kualifikuar

Ju keni këto mundësi për të hyrë në Gjermani për qëllime pune:

1. Punësimi në kuadër të Rregullores së Ballkanit Perëndimor

Për shtetasit nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Serbia ekziston e ashtuquajtura “Rregullorja e Ballkanit Perëndimor” (neni 26 paragrafi 2 i Rregullores së Punësimit). Sipas kësaj rregulloreje, Agjencia Federale e Punësimit mund të japë me kontroll prioritar miratimin për ushtrimin e çdo punësimi. Juve ju duhet një kontratë pune ose një ofertë pune të lidhur. **Njohja e kualifikimit tuaj nuk është një kusht**, përveçse nëse doni të punoni në një profesion të rregulluar si mjekë ose mjekë.

2. Punësimi si “Punëtorë i kualifikuar”

Ju mund të synoni imigrimin si profesionist. **Për aplikimin për vizë për qëllime punësimi si profesionist, keni nevojë përveç një oferte konkrete pune edhe për dëshminë e kualifikimit tuaj që është njohur në Gjermani ose është ekuivalente me një diplom gjermane.** Kjo vlen për punësim në profesione të rregulluara dhe jo të rregulluara.

Se si mund ta bëni njohjen e kualifikimit tuaj të huaj në Gjermani, mund të informoheni në faqen informative të Qeverisë Federale (Njohja në Gjermani) “Recognition in Germany”. Ju mund të konsultoheni edhe tek (Qendra Kryesore për njohjen e profesionit) Service Center for Professional Recognition.

2.1 Hyrja në vend për njohjen e kualifikimeve të huaja

A keni aplikuar për njohjen e kualifikimit tuaj dhe ky nuk është njohur plotësisht? Ju gjithashtu keni mundësinë të absolvoni masa kualifikimi në Gjermani, për të marrë njohjen e plotë. Për këtë arsye, ju duhet të aplikoni (për një vizë për njohjen e kualifikimeve profesionale të huaja) pranë zyrës përgjegjëse “Visa for the recognition of foreign qualifications”.

i Rubrik informative: Partneriteti i njohjes

Nga 1 marsi 2024, do të hyjë në fuqi mundësia e hyrjes në vend dhe punësimit në kuadër të partneritetit të njohjes: Me partneritetin e njohjes, ju mund të merrni leje qëndrimin për ushtrimin e një punësimi të kualifikuar dhe të kryeni procedurën e nevojshme të njohjes vetëm pas hyrjes në vend. Informacione të mëtejshme mund ti gjeni në portalin “Make it in Germany” në rubrikën (“Viza & Qëndrim”) “Visa & residence”.

2.2 Hyrja në vend për të kërkuar punë

Në kushte të caktuara, ju mund të hyrni në vend edhe për të kërkuar punë. Që nga 1 qershori 2024, për këtë qëllim ju mund të aplikoni për një vizë Chancenkarte (kartë mundësie) në zyrën e jashtme gjermane përkatëse ose - nëse jeni tashmë në Gjermani me një leje qëndrimi - pranë zyrës për të huaj (Ausländerbehörde).

Ne ju njoftojmë për “procedurën e përshpejtuar për punëtorë të kualifikuar” të krijuar në vitin 2020, ku punëdhënësi juaj i ardhshëm në Gjermani mund të nisë procesin e hyrjes në vend kundrejt një tarife të veçantë. Kjo procedurë ka të bëjë me përshpejtimin e përpunimit për autoritetet e përfshira, duke përfshirë edhe zyrat e vizave. Hyrja në vend në kuadër të Rregullores të Ballkanit Perëndimor me procedurën e përshpejtuar të punëtorëve të kualifikuar nuk është e mundur.

Këtu mund të gjeni informacione të dobishme rreth rregullave aktuale për imigrimin e punëtorëve të kualifikuar: <https://www.make-it-in-germany.com/en/visa-residence/skilled-immigration-act>.